



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 244/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi për kërkesën e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohen të tërhequra ankesat me numër: Anr.211/2013, Anr.212/2013 Anr. 213/2013, Anr.214/2013, Anr.215/2013 Anr.216/2013 Anr.217/2013 Anr.218/2013 Anr.219/2013 Anr.220/2013 Anr.221/2013 Anr.222/2013 Anr.223/2013 Anr.224/2013 Anr.225/2013 Anr.226/2013ë Anr.227/2013 Anr.228/2013 Anr.229/2013 Anr.230/2013 datës 09.10.2013, te parashtruara në PZAP nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP, me datë 11.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.211/2013, Anr.212/2013 Anr. 213/2013, Anr.214/2013, Anr.215/2013 Anr.216/2013 Anr.217/2013 Anr.218/2013 Anr.219/2013 Anr.220/2013 Anr.221/2013 Anr.222/2013 Anr.223/2013 Anr.224/2013 Anr.225/2013 Anr.226/2013ë Anr.227/2013 Anr.228/2013 Anr.229/2013 Anr.230/2013 datës 09.10.2013, te parashtruara në PZAP, kundër subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK) në të cilën kërkohet që të tërhiqen ankesat e lartpërmendura nga shqyrtimi, në qoftë se të njëjtat nuk janë shqyrtuar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave të sipërshehënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos te shqyrtohen ankesat në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 244/2013 më datën 17.10.2013

